



**INVESTIMET KAPITALE NGA
MINISTRITË E LINJËS
NË KOMPETENCA KOMUNALE
PËR PERIUDHËN 2011 - 2017**

INVESTIMET KAPITALE NGA
MINISTRITË E LINJËS
NË KOMPETENCA KOMUNALE
PËR PERIUDHËN 2011 - 2017

Mars, 2019

Ky raport është përgatitur nga RECURA Financials për projektin e SDC-së – DEMOS, i cili zbatohet nga HELVETAS Swiss Intercooperation

Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e SDC-së dhe HELVETAS Swiss Intercooperation.

©DEMOS

Publikuar: mars 2019

Prishtinë, Kosova

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	4
1. Fushëveprimi i punës, metodologjia dhe qasja	5
2. Investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetenca komunale	6
2.1. Investitorët më të mëdhenj në kompetenca komunale	9
2.2. Përfituesit më të mëdhenj të investimeve kapitale në kompetenca komunale	10
2.3. Proceset e vendimmarrjes së Ministrisë së linjës mbi investimet kapitale në kompetenca komunale.....	11
3. Konkluzionet	13
4. Rekomandime	14
Shtojca I - Investimet Kapitale nga Ministritë sipas Komunave	16
Shtojca II - Investimet Kapitale nga Ministritë për Komuna për kokë banori	17
Shtojca III - Shpenzimet Kapitale të Ministrisë në Fushat e Kompetencave Komunale	18
Shtojca IV - Shpenzimet Kapitale të Ministrive të linjës në Kompetenca Komunale si % e buxhetit të tyre për Investime Kapitale	19
Shtojca V - Shpenzimet Kapitale të Ministrive të linjës në Kompetenca Komunale si % totale e buxhetit komunal si dhe buxhetit komunal për investime kapitale.....	20
Shtojca VI - Shpenzimet Kapitale në Komuna të ndara sipas burimeve të financimit	21

Përmbledhje ekzekutive

Komunat në Kosovë marrin grante qeveritare vjetore të përgjithshme për investime kapitale. Përveç kësaj, komunat gjithashtu përfitojnë projekte kapitale të investuara nga ministritë e linjës. Këto investime bien në fushat e kompetencave komunale, por financohen nga ministritë përkatëse të linjës.

Bazuar në të dhënat e Thesarit të Kosovës, për periudhën ndërmjet vitit 2011 dhe 2017, vlerësimi jonë është se ministritë e linjës kanë zbatuar rreth 930 projekte të ndryshme kapitale që bien në kuadër të kompetencave të pushtetit lokal. Vlera e përgjithshme e këtyre investimeve ishte mesatarisht 311 mil euro ose 44.47 mil euro në vit.¹ Investitori më i madh ishte Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (MIT) me 148 mil euro ose 47% të vlerës totale të investuar, ndjekur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me 70 mil euro ose 22% dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) me 28 mil euro ose 9% të totalit.

Përfituesi më i madh komunal i investimeve të bëra nga ministritë e linjës ishte komuna e Skenderajt, e cila mori 43 mil euro ose 13.9% të vlerës totale të investuar në kompetenca komunale. Ndiqet nga komuna e Prishtinës me 21.7 mil euro ose 6.9% dhe komuna e Pejës me 20.8 mil euro ose 6.7% të totalit. Sa i përket investimeve për kokë banori, përfituesi më i madh ishte komuna e Skenderajt me 822 euro për kokë banori, ndjekur nga komuna e Shtimes me 385.5 euro për kokë banori dhe komuna e Hanit të Elezit me 363.3 euro për kokë banori.

Aktualisht, nuk ka ligje formale ose udhëzime qeveritare për zbatimin e projekteve kapitale nga ministritë e linjës në kompetenca komunale. Prandaj, nuk është e qartë nëse korniza aktuale ligjore lejon apo kufizon ministritë e linjës që të zbatojnë projekte të tilla kapitale nga buxheti i tyre.

Si pjesë e studimit tonë, ne kemi vizituar katër ministri të linjës që kanë zbatuar projekte kapitale në kompetencat komunale. Gjetjet tregojnë se tri nga ministritë nuk kanë pasur rregullore ose udhëzues të brendshëm për procesin e vendimmarrjes dhe kritere të përzgjedhjes për financimin e projekteve kapitale për përfituesit komunalë. Në praktikë, ato ministri kanë ndjekur procedurat joformale ku komunat kanë paraqitur kërkesa me shkrim në ministri për të financuar një projekt të caktuar. Kërkesa dhe arsyetimi i projektit janë analizuar nga departamenti përgjegjës për fushën përkatëse dhe më pas nga kabineti i ministrit, i cili vlerësoi opsionet, prioritetet dhe e bëri të prerë vendimin për projektet që do të financohen. Aktivitetet e prokurimit u udhëhoqën nga ministritë e linjës. Në rastin e Ministrisë së Infrastrukturës, prokurimi i projekteve nën 500,000 euro u realizua nga përfituesi komunal.

Për më tepër, në varësi të natyrës dhe fushëveprimit të projektit, u caktua një menaxher i kontratës goftë nga ministria ose përfituesi komunal. Zbatimi i projektit u mbikëqyr nga stafi i ministrisë. Faturat e kontraktorëve u paguan nga ministria që pranoi dorëzimin e produktit final dhe më pas e transferoi tek përfituesi komunal.

Në mungesë të procedurave formale, vendimet e investimeve të marra nga ministritë e linjës krijojnë rreziqe për investime joproporcionale dhe të pabarabarta në të gjitha komunat e Kosovës.

¹ Në llogaritjen e numrit total të projekteve të investuara nga ministritë e linjës në kompetencat komunale, ne kemi ndjekur një qasje konservative. Kjo nënkupton se kemi përjashtuar të gjitha ato projekte kapitale nga ministritë për të cilat nuk kemi pasur një siguri të nivelit të lartë se i përkisnin vetëm kompetencave komunale.

1. FUSHËVEPRIMI I PUNËS, METODOLOGJIA DHE QASJA

Studimi u përqendrua në projektet kapitale të investuara nga ministritë e linjës në komuna në fushatë nën kompetenca komunale.

Objektivi i studimit ishte të përcaktohej se si vendosin ministritë e linjës për këto investime dhe të jepeshin rekomandime për përmirësimin e procesit në përgjithësi. Për të arritur këtë objektivi, ne kemi analizuar dhe shqyrtuar:

- i. Projektet kapitale të investuara nga ministritë e linjës në kompetenca komunale për periudhën 2011-2017; dhe
- ii. Procedurat e vendimmarrjes për dhënie dhe disbursimin e fondeve për investime kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale.

Për të përcaktuar shumën totale të investimeve kapitale, ne:

- Kemi analizuar ligjet buxhetore të Kosovës për të identifikuar numrin e fondeve në dispozicion të ministrive të linjës për investime kapitale në kompetencat komunale,
- Kemi analizuar të dhënat e Thesarit të Kosovës nga Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) për të identifikuar shumën totale që secila ministri e linjës ka investuar në kompetencat komunale, në veçanti:
 - vlerën e projekteve kapitale të investuara për çdo vit për periudhën 2011 - 2017
 - vlerën e projekteve kapitale të investuar nga secila ministri e linjës, dhe
 - vlerën e projekteve kapital të investuar në secilën komunë, në total dhe për kokë banori,
- Kemi analizuar të dhënat dhe raportin e prodhuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për "Analizën e Investimeve Kapitale në Komuna për vitet 2011 - 2016".

Për të përcaktuar se si ministritë marrin vendime për investimet kapitale, ne:

- Kemi analizuar kornizën ligjore të Kosovës për të përcaktuar nëse ka procedura ekzistuese që lejojnë ministritë e linjës të investojnë në kompetencat komunale,
- Kemi mbajtur intervista në MAPL, MIT, Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në lidhje me procesin e tyre të vendimmarrjes për investimet në kompetencat komunale, në veçanti:
 - A kishte kritere? Kush i vlerësoi opsionet? Kush vendosi për to?
 - Kush e menaxhoi kontratën? Kush monitoroi projektet? Kush i bëri pagesat?

Për të siguruar koordinimin e projektit dhe për të përafuar nevojat dhe pritjet e palëve të interesit, ne:

- Jemi takuar me departamentin e buxhetit në kuadër të Ministrisë së Financave (MF)

2. INVESTIMET KAPITALE NGA MINISTRITË E LINJËS NË KOMPETENCA KOMUNALE

Financat komunale për investimet kapitale vijnë nga burime të ndryshme, kryesisht grante qeveritare, të hyra vetanake, grante të donatorëve dhe disa burime të tjera të vlerave më të vogla. Përveç kësaj, komunat e Kosovës marrin fonde nga ministri të ndryshme të linjës për projektet kapitale që bien në kompetencat komunale.

Gjatë periudhës 2011 - 2017, buxhetet totale të ministrive të linjës për investimet kapitale në fushën e kompetencave komunale ishin në shumën prej 408,757,722 euro. Për periudhën e njëjtë, ministrinë e linjës kanë shpenzuar 311,374,427 euro ose 76% të shumave të buxhetuara - shih figurën më poshtë.

Kjo shumë është përdorur për të financuar më shumë se 930 projekte të ndryshme kapitale në fusha të ndryshme të kompetencave komunale. Kështu, ministrinë e linjës kanë shpenzuar mesatarisht rreth 44.47 mil euro në vit.




Figura 1. Investimet totale kapitale nga ministrinë e linjës në kompetenca komunale për vitet 2011 – 2017

Gjatë periudhës 2011 - 2017, 12 ministri të linjës shpenzuan 311 mil euro ose 12.73% të buxheteve të përgjithshme të tyre kapitale për investime që bien në kompetenca komunale.




Figura 2. Investimet kapitale nga 12 ministri të linjës në kompetenca komunale për periudhën 2011 - 2017

Këto investime janë bërë krahas investimeve kapitale të financuara përmes një granti të përgjithshëm për komunat, të cilat ishin 524,184,842 euro për periudhën shtatëvjeçare. Krahas këtyre fondeve, komunat po ashtu përdorën 5,528,271 euro të granteve kapitale nga Bashkimi Evropian (BE) dhe 4,399,000 euro nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC), projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), si grant i performancës që u lansua në vitin 2015. Kështu, për periudhën 2011 - 2017, nga këto katër burime të financimit, komunat bënë investime kapitale në shumën totale prej 845,486,540 euro. Gjatë kësaj periudhe, nuk kishte investime kapitale në komuna të financuara nga kreditë.




Figura 3. Burimet kryesore buxhetore të investimeve kapitale në komuna për periudhën 2011 – 2017

Siç tregohet në tabelën 1, për periudhën 2011 - 2017, investimet nga ministritë e linjës në kompetenca komunale përbënin 37% të projekteve të përgjithshme kapitale të investuara në komunat e Kosovës duke përdorur katër burime buxhetore. Shtojca 6 jep analizë të detajuar të burimeve buxhetore të investimeve të zbërthyer sipas komunave.

Tabela 1: Investimet kapitale (IK) në komuna, të ndara sipas burimeve të financimit për periudhën 2011 - 2017

IK nga ministritë në kompetenca komunale		IK në grant të përgjithshëm për komunat		IK përmes grantit të performancës së projektit DEMOS të SDC		IK financiar nga Grantet e Bashkimit Evropian		Gjithsej IK në komuna
Në €000,	% e totalit	Në €000	% e totalit	Në €000	% e totalit	Në €000	% e totalit	Në €000
311,374	36.8	524,184	62.0	4,399	0.52%	5,528	0.65%	845,486

Tabela 2 më poshtë tregon se për periudhën shtatëvjeçare, IK nga ministritë e linjës në kompetenca komunale ishin 2.8% e shumës totale të buxhetit të Kosovës. Në vitin 2016 dhe 2017, këto investime si përqindje e buxhetit të Kosovës ishin pak më të ulëta në krahasim me vitet e kaluara, kryesisht për shkak se u tejkaluan nga rritja e buxhetit të Kosovës.

Për më tepër, IK në kompetencat komunale ishin mesatarisht 62.7% në krahasim me IK në grant të përgjithshëm për komunat. Në vitin 2017, këto investime arritën 78 pikë përqindjeje pasi që IK nga ministritë e linjës janë rritur, ndërsa IK në grant të përgjithshëm janë zvogëluar gjatë viteve.

Përderisa granti i performancës i SDC/DEMOS dhe Granti i BE-së për IK përbëjnë 1.5% dhe 2% të IK totale në komuna. Në krahasim me investimet në kompetenca komunale, këto grante ishin 1.4% dhe 1.77%. Granti i performancës i DEMOS për komuna filloi në vitin 2015. Ndërsa në vitin 2012 dhe 2013 nuk kishte grante të BE-së për IK në komuna. Shtojca VI e këtij raporti jep detaje të ndara të shifrave në tabelën 2 për secilën komunë.

Tabela 2: Investimet kapitale (IK) nga ministritë e linjës në kompetencat komunale (KK) në baza krahasuese (2011 - 2017)

Viti	IK nga ministritë në KK Në €000	IK në KK si një % e buxhetit të Kosovës		IK në KK si një % e IK në grant të përgjithshëm për komunat		IK në KK si një % e grantit të performancës së DEMOS		IK në KK si një % e grantit të BE-së	
		Buxheti i Kosovës [Shpenzimet] në €000	Në %	CI në Grant të Përgjithshëm Në €000	Në %	Granti i Performancës i DEMOS në €000	Në %	Grante të BE-së në €000	Në %
2011	40,804	1,400,462	2.9	86,163	47	-	-	0	-
2012	35,636	1,466,457	2.4	78,223	46	-	-	0	-
2013	43,445	1,500,176	2.9	84,159	52	-	-	864	2
2014	51,039	1,498,399	3.4	90,214	57	-	-	155	0.3
2015	44,832	1,315,184	3.4	57,825	78	1,818	4	1,917	4.3
2016	43,201	1,750,675	2.5	60,579	71	988	2.3	2,117	5
2017	52,417	2,001,020	2.6	67,021	78	1,593	3	476	0.9
Totali	311,374	10,932,373	2.8	524,184	62.7	4,399	1.41	5,528	1.77

Tabela 3 tregon se për vitet 2011 - 2017, investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetenca komunale ishin mesatarisht 75% e shumës totale të të Hyrave Vetanake (THV) komunale. Tabela 3 tregon se për periudhën 2011 - 2017, investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetencat komunale ishin mesatarisht 75% e shumës totale të THV-ve komunale. Në vitin 2017, këto investime arritën 82% të THV-ve pasi që në atë vit u rritën IK-të ndërsa THV-të e mbledhura kanë rënë. Krahasuar me tatimin në pronë të mbledhur (duke përfshirë borxhet, interesin dhe gjobat), investimet e tilla kapitale ishin mesatarisht 2.3 herë më të larta.

Tabela 3: Investimet Kapitale (IK) nga ministritë e linjës në kompetenca komunale në krahasim me të Hyrat Vetanake (THV) të përgjithshme Komunale dhe Tatimin në Pronë (2011 - 2017)

Viti	IK nga ministritë në kompetenca komunale	IK në kompetenca komunale si % e THV komunale		IK në kompetenca komunale si një % e Tatimit Komunal në Pronë	
		THV komunale	%	Tatimi Komunal në Pronë	%
2011	40,803,717	49,762,068.1	82%	14,363,922	284.1%
2012	35,636,371	59,538,267.0	60%	14,584,118	244.4%
2013	43,445,179	55,797,766.2	78%	16,119,339	269.5%
2014	51,039,005	60,698,092.7	84%	20,411,152	250.1%
2015	44,832,206	57,886,316.3	77%	19,795,834	226.5%
2016	43,200,604	69,849,846.2	62%	25,123,331	172.0%
2017	52,417,346	64,276,378.9	82%	22,406,983	233.9%
Totali	311,374,427	417,808,735	75%	132,804,680	234.5%

2.1. Investitorët më të mëdhenj në kompetenca komunale

Për periudhën shtatëvjeçare ndërmjet viteve 2011 dhe 2017, 12 ministri të linjës kanë investuar projekte kapitale në kompetenca komunale. Në mesin e tyre, investitorët më të mëdhenj ishin MI me €148 milion ose 47% të vlerës totale të investuar, pasuar nga MASHT me €70 milion ose 22% dhe MKRS me €28 milion ose 9% të totalit.

Tabela 4: Investitorët më të mëdhenj në kompetenca komunale për vitet 2011-2017

Ministria Në €	Buxheti (000)		Shpenzimet (000)	
	Në %	Në €	Në %	Në €
1 Ministria e Infrastrukturës	196,462	48.6	148,434	47.6
2 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	81,863	20	70,090	22.5
3 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	44,007	10.7	28,198	9
4 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	28,806	7	19,922	6.4
5 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	28,179	6.9	17,586	5.6

Investimet e MI-së në kompetenca komunale përbënin rreth 9% të buxhetit të saj total për IK. Tjetra, MAPL ka përdorur 70% të buxhetit të saj kapital për investime në kompetenca komunale, MKRS 48%, MASHT 43% dhe kështu me radhë.

Tabela 5: Investimet në kompetenca komunale si % e buxhetit për IK për periudhën 2011 - 2017

Ministria Në € (000)	Buxheti total për IK	Gjithsej IK në kompetenca komunale	IK në kompetenca komunale si % e buxhetit komunal për IK
	Në € (000)	Në %	
1 Infrastrukturë	1,621,782	148,433	9.15
2 Arsim, Shkencë dhe Teknologji	161,889	70,089	43.29
3 Kulturë, Rini dhe Sport	57,916	28,198	48.69
4 Administrim i Pushtetit Lokal	28,242	19,921	70.54
5 Mjedis dhe Planifikim Hapësinor	225,842	17,585	7.79

2.2. Përfituesit më të mëdhenj të investimeve kapitale në kompetenca komunale

Për vitet 2011 - 2017, ministritë e linjës investuan projekte kapitale në të gjitha (38) komunat në Kosovë, edhe pse disa komuna individuale kanë përfituruar më shumë. Komunat që kanë përfituruar më së shumti, në vlerë euro, ishin komuna e Skenderajt, e cila mori 43 mil euro ose 13.9 % të investimeve totale të bëra në kompetenca komunale. Ndiqet nga komuna e Prishtinës me 21.7 mil euro ose 6.9% dhe komuna e Pejës me 20.8 mil euro ose 6.7% të totalit.

Tabela 6: Përfituesit më të mëdhenj të investimeve në kompetenca komunale për vitet 2011 - 2017

Komuna Në €	Buxheti (000)		Shpenzimet (000)	
	Në %	Në €	Në %	Në €
1 Komuna e Skenderajt	65,497	16	43,352	13.9
2 Komuna e Prishtinës	32,543	7.9	21,727	6.9
3 Komuna e Pejës	22,971	5.6	20,864	6.7
4 Komuna e Gjilanit	19,215	4.7	15,941	5.1
5 Komuna e Ferizajt	17,900	4.3	15,279	4.9
6 Komuna e Podujevës	16,393	4	15,274	4.9
7 Komuna e Prizrenit	20,660	5	14,002	4.5

Sa i përket investimeve për kokë banori, komuna e Skenderajt ishte përfituesi më i madh me 822.5 euro për kokë banori, që është shifër dukshëm më e lartë se Komuna e Shtimes, e cila është në vendin e dytë me 385.3 euro për kokë banori, dhe më pas komuna e Hanit të Elezit, e cila është në vendin e tretë me 363.8 euro për kokë banori.

Tabela 7: Përfituesit më të mëdhenj të investimeve në kompetenca komunale për periudhën 2011 - 2017 (për kokë banori)²

Komuna	Shpenzimet (€000)	Popullsia	Shpenzimet për kokë banori
1 Komuna e Skenderajt	43,353	52,711	822.5
2 Komuna e Shtimes	10,735	27,864	385.3
3 Komuna e Hanit të Elezit	3,641	10,009	363.8
4 Komuna e Junikut	2,213	6,482	341.4
5 Komuna e Istogut	11,467	40,271	284.7
6 Komuna e Kaçanikut	9,330	34,312	271.9
7 Komuna e Klllokotit	668	2,741	243.6

Për periudhën 2011 - 2017, 13 komuna (analizuar si mostër), kanë marrë IK shtesë në vlera të konsiderueshme në proporcion me buxhetin e tyre për IK që variojnë ndërmjet 7.6% në komunën e Prishtinës deri në 183% në komunën e Skenderajt. Mesatarisht, këto komuna kanë marrë 26.47% të buxheteve të tyre për IK.

² Numrat e popullsisë sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës - Vlerësimi 2017. Grantet për kokë banori për komunat e veriut të përjashtuara nga llogaritja për shkak të kushteve të veçanta të financimit nëpërmjet modelit të të hyrave të pikës doganore në veri.

Tabela 8: Investimet kapitale nga ministritë e linjës në kompetenca komunale si % e totalit të komunës dhe buxhetit të IK për periudhën 2011 - 2017

Komuna Në € (000)		Buxheti total komunal	Buxheti komunal për IK	IK shtesë nga ministritë e linjës	IK shtesë si % e buxhetit total komunal	IK shtesë si % e buxhetit komunal për IK
		Në € (000)	Në € (000)	Në %	Në %	Në %
1	Skenderaj	79,792	23,674	43,352	54.3	183.1
2	Prishtinë	553,864	287,171	21,727	3.9	7.6
3	Pejë	148,720	42,252	20,864	14.0	49.4
4	Gjilan	151,675	31,635	15,941	10.5	50.4
5	Ferizaj	172,348	62,178	15,279	8.9	24.6
6	Podujevë	126,764	41,725	15,274	12.0	36.6
7	Prizren	240,267	137,597	14,002	5.8	10.2
8	Shtime	38,750	9,892	10,735	27.7	108.5
9	Hani i Elezit	14,714	4,055	3,641	24.7	89.8
10	Junik	10,279	2,414	2,213	21.5	91.7
11	Istog	61,085	16,930	11,467	18.8	67.7
12	Kaçanik	45,814	10,558	2,892	6.3	27.4
13	Klllokot	8,066	2,552	667	8.3	26.2

Siç mund të shihet në tabelat e mësipërme dhe në analizën e detajuar të bashkëngjitur si shtojcë, gjatë periudhës 2011 - 2017, disa komuna kanë marrë më shumë investime se të tjerat, edhe kur merren parasysh madhësia e komunës, popullsia, niveli i zhvillimit ekonomik dhe karakteristikat e tjera.

2.3. Proceset e vendimmarrjes së Ministrisë së linjës mbi investimet kapitale në kompetenca komunale

Në parim, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Ligji për Vetëqeverisje Lokale (LVL) dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL), si dhe legjislatura specifike për sektorin përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë ndërmjet ministrive dhe komunave, megjithëse jo gjithmonë në një mënyrë të qartë.³

Çdo vit, një numër i konsiderueshëm i ministrive të linjës investojnë projekte kapitale në komuna në fushën e kompetencave komunale. Përkundër kësaj, nuk ka ligje formale ose udhëzime qeveritare për investimet kapitale në kompetencat komunale. Prandaj, nga perspektiva ligjore, nuk është e qartë nëse investimet në kompetenca komunale janë plotësisht në përputhje.

Megjithatë, vit pas viti, ministritë e linjës zbatojnë projekte në fushën e kompetencave komunale dhe vlera e investimeve të tilla është e konsiderueshme. Mostra e 13 komunave të analizuar mori investime shtesë nga ministritë e linjës në vlerën prej rreth 178 mil euro. Kjo përbënte 10.78% të buxheteve të tyre totale ose 26.47% të buxheteve të tyre për investime kapitale mesatarisht për të njëjtën periudhë.

Investimet kapitale për kompetencat komunale janë planifikuar nga ministritë e linjës si pjesë e procesit të tyre të përgatitjes së buxhetit vjetor. Prandaj, investimet kapitale për një vit të caktuar fiskal janë planifikuar në përputhje me kërkesat e ligjit për MFPP.

³ Legjislacioni specifik në arsim, shëndetësi, mjedis, kulturë, infrastrukturë publike etj.

Procesi i planifikimit fillon në fillim të vitit me Programin për Reforma Ekonomike (PRE) nga niveli qendror, që ndihmon përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH).⁴ Këto dokumente, duke përfshirë legjislacionin specifik për sektorin, ligjet e buxheteve vjetore dhe Ligjin për MFPP, janë përdorur nga ministritë e linjës si kriteret dhe referencat kryesore për vendosje mbi investimet në kompetenca komunale. Përveç këtyre dokumenteve të përgjithshme, nuk ka rregullore ose procedura formale që përcaktojnë kriteret dhe procese për përzgjedhjen e projekteve kapitale që bien në kuadër të përgjegjësisë financiare komunale.

Nga 12 ministritë që kanë kryer investime në kompetenca komunale, ne kemi qenë në gjendje të konfirmojmë se vetëm MAPL kishte kriteret specifikë për procesin e vendimmarrjes për IK të tilla.

Tri ministritë e tjera ku zhvilluam intervista, kishin mungesë të proceseve dhe kriterëve formale në lidhje me këto investime.⁵ Megjithatë, në praktikë, këto ministri ndoqën procedura joformale në lidhje me pranimin e kërkesave komunale për mbështetje financiare, vlerësim të projekteve, prioritizim dhe procedura të përzgjedhjes si dhe mekanizma të prokurimit dhe monitorimit të projekteve. Tabela më poshtë tregon hapat kryesorë të procesit të vendimmarrjes në një renditje sekuenciale.

Tabela 8: Procesi i vendimmarrjes në ministritë e linjës për investime në kompetenca komunale

1.	Një komunë paraqet një kërkesë për mbështetje tek departamenti përgjegjës për një projekt në kuadër të ministrisë ose Kabinetit të Ministrit. Nëse kërkesa dorëzohet tek Kabineti i Ministrit, Ministri e dërgon kërkesën tek departamenti përkatës.
2.	Departamenti përkatës vlerëson nëse projekti është i nevojshëm, i arsyeshëm dhe i arritshëm.
3.	Kërkesat që konsiderohen si të përshtatshme dërgohen tek Kabineti i Ministrit.
4.	Kabineti i Ministrit përpilon listën e projekteve që shqyrtohet si pjesë e procesit të rregullt të përgatitjes së buxhetit.
5.	Kabineti i Ministrit, Drejtori i Buxhetit dhe Financave dhe drejtorët e tjerë të departamenteve vendosin për projektet që do të sponsorizohen për vitin e ardhshëm sipas Ministrisë dhe strategjisë së përgjithshme të Qeverisë së Kosovës. Një konsideratë e mëtejshme i jepet buxhetit total të investimeve në dispozicion.
6.	Nëse miratohet një projekt i kërkuar nga komunat, nënshkruhet një marrëveshje "memorandum mirëkuptimi" ndërmjet komunës dhe ministrisë në lidhje me zbatimin e projektit.
7.	Procedurat e prokurimit dhe procedurat e menaxhimit të kontratës kryhen kryesisht nga komuna. ⁶
8.	Ministria cakton një mbikëqyrës për projektin që monitoron progresin e komunës përfituese në zbatimin e një projekti.
9.	Procesi i pranimin të punëve/mallrave bëhet bashkërisht nga komuna dhe ministria.
10.	Produkti final regjistrohet në llogari të Ministrisë si aset dhe më pas transferohet tek komuna.

Përveç atyre më sipër, MSH ka kryer një analizë më të detajuar të nevojave komunale për projektin e

⁴ PRE dhe KASH parashohin strategjitë kryesore ekonomike dhe të investimit për shtetin e Kosovës dhe të gjitha organizatat e nivelit qendror përdorin kriteret në këto dokumente për të udhëhequr vendimmarrjen e tyre në lidhje me projektet specifike.

⁵ Ministria e Infrastrukturës (MI), Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

⁶ Zyrtari i intervistuar nga Recura sqaroi gjithashtu se në disa raste MMPH kreu vetë procedurat e prokurimit dhe të menaxhimit të kontratës për shkak të madhësisë së madhe të kontratës dhe mungesës së kapaciteteve nga komunat përfituese për të ekzekutuar një kontratë të madhe. Kjo po ashtu vlente edhe për Ministrinë e Infrastrukturës.

kërkuar dhe ekipi i saj i vlerësimit ka kryer vizita në terren për të vlerësuar nevojat komunale. Përdërisa në MIT, për projekte nën 500,000 euro, procedurat e prokurimit janë udhëhequr nga komunat. Si rezultat, kjo mungesë e përgjithshme e rregullimit formal për investime me kompetenca të ndërthurura lë një boshllëk ligjor në sigurimin e një qasjeje të barabartë dhe për të drejtuar mbështetjen financiare të nivelit qendror për të gjitha komunat në Kosovë.

MSH po ashtu ndjek procedura të ngjashme, përveç kalimit nëpër një hap shtesë, edhe pse joformal, të drejtimit të një analize të nevojave për projektet e kërkuara nga komunat.

3. KONKLUZIONET

Nga viti 2011 deri në vitin 2017, ministritë e linjës kanë shpenzuar një minimum prej 311 milion euro për IK në fushat që bien në përgjegjësinë e komunave.⁷ Katër Ministritë e intervistuar kanë shpjeguar se kanë investuar në kompetenca komunale sepse komunat nuk kanë mjetet për të vetë-financuar projektet.

Ndërsa një formë e një procesi joformal të përzgjedhjes për secilin projekt duket se është ndjekur brenda të paktën dy ministrive, nuk ka kritere dhe procese formale dhe zyrtare për përzgjedhjen e këtyre projekteve. Përveç kësaj, duke pasur parasysh që vendimi final për investim bie nën përgjegjësinë e Kabinetit të Ministrit, mungesa e një kornize formale hap procesin ndaj një rreziku të konsiderueshëm të paragjyqimeve.

Analiza e pranuesve tregon se ka pasur devijim të konsiderueshëm në projektet e financuara nga niveli qendror që bien nën kompetenca financiare komunale. IK për kokë banori e komunave përfituese po ashtu tregojnë një mospërputhje të madhe midis përfituesit më të madh (822.5 euro për kokë banori) dhe të dytit më të madh (385.3 euro për kokë banori).

Këto mospërputhje mund të jenë për shkak të politikave të barazimit ekonomik që synojnë të ndihmojnë rajonet e pazhvilluara të Kosovës. Megjithatë, në lidhje me mungesën e një strategjie kombëtare dhe kritereve dhe proceseve të qarta për përzgjedhjen e projekteve, është vështirë të vërtetohet ky argument.

Mungesa e procedurave të shkruara dhe një sërë kriteresh për përzgjedhjen e projekteve kapitale në kuadër të kompetencave komunale lë hapësirë të konsiderueshme për vendimmarrje të njëanshme dhe shpërndarje të fondeve në mënyrë të njëanshme. Krahas kësaj, analiza sasiore e të dhënave të buxhetimit dhe të shpenzimeve tregon se disa komuna janë financuar së tepërmi në krahasim me të tjerat.

Për të siguruar një shpërndarje më të drejtë dhe më efektive të shpenzimeve kapitale nëpër komunat e Kosovës, është e domosdoshme që Kosova ta zhvillojë një listë të kritereve dhe procesin formal të shqyrtimit të projekteve për mbështetje komunale të projekteve.

⁷ Këto shuma përfshijnë shumat e lidhura vetëm me projektet që janë lehtësisht të identifikueshme si të tilla që bien në kompetencë të komunave. Megjithatë, një analizë më sistematike e të dhënave të Programit të Zbatimit të Projektit të Ministrisë së Financave do të rezultojë në një shumë më të lartë në shpenzime dhe buxhetim.

4. REKOMANDIME

Çfarë është bërë deri tani

Gjetjet e këtij raporti janë diskutuar më parë me Drejtorin e Departamentit të Buxhetit në MF, si dhe me zyrtarët financiarë nga MASHT dhe MMPH. Si rezultat, disa nga masat e rekomanduara në këtë raport janë adresuar tashmë dhe/ose janë në proces të adresimit.

MF ka përfshirë një dispozitë në ligjin për buxhetin vjetor 2019 që përcakton se secila Organizatë Buxhetore (OB) e projekteve të financimit të nivelit qendror në nivel lokal nën financim të rregullt komunal do të zbatojë kritere të qarta, të drejta dhe transparente. MASHT ka hartuar tashmë një udhëzim administrativ të brendshëm që rregullon ndërtimin e shkollave në komunat e Kosovës.

Hapat e ardhshëm

1. MAPL, së bashku me ministritë e tjera të linjës që kanë shpenzuar para në kompetenca komunale, duhet të konsiderojë kryerjen e një analize të hollësishme të nevojave të përgjithshme komunale për investime kapitale. Duhet të mbledhë dhe analizojë informacione për Strategjitë e Investimeve Kapitale nga secila komunë dhe të bëjë një listë të projekteve që nevojiten më së shumti, duke përfshirë ato që kërkojnë ligjërisht. Pastaj fokusi duhet të jetë për të përcaktuar nëse niveli aktual i Granteve Qeveritare (GQ) siguron buxhet të mjaftueshëm për financimin e tyre. Për më tepër, rezultatet e kësaj analize mund të përdoren si bazë për të përcaktuar madhësinë e buxhetit që nevojitet për mbështetje komunale, duke përfshirë Skemën e Buxhetit të Bazuar në Performancë të udhëhequr nga MAPL. Mund të përdoret edhe si input për hartimin e një politike konsistente qeveritare në lidhje me investimet në kompetenca komunale.
2. Më tej, pas përfshirjes së kërkesës në ligjin për buxhet për zhvillimin e kritereve për investime në kompetenca komunale, departamenti i buxhetit i MF duhet të mbështesë më tej ministritë e linjës në zhvillimin e rregulloreve dhe/ose udhëzimeve administrative të tilla. Mund ta bëjë këtë duke lëshuar një dokument udhëzues me parime të përgjithshme, kërkesa minimale dhe procesin për zhvillimin e rregulloreve dhe/ose udhëzimeve administrative. Përveç kësaj, MF duhet të monitorojë nga afër zbatimin e kërkesave të tilla.
3. Shembuj ekzistues nga MAPL dhe MASHT mund të përdoren si model nga ministritë e tjera. Megjithatë parimet dhe kërkesat e përgjithshme duhet të përshtaten për nevojat dhe kërkesat specifike të secilës ministri. Së paku, duhet të përfshijë:
 - a. Fushat prioritare, kushtet dhe kërkesat e kualifikueshmërisë për financimin e projekteve kapitale në kompetenca komunale;
 - b. Një proces të hapur publik për dorëzimin e kërkesave komunale për investime kapitale duke ofruar qasje transparente dhe të barabartë në mundësitë e financimit për të gjitha komunat;
 - c. Kërkesat e kualifikueshmërisë si dhe kritere specifike dhe të matshme për vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve komunale për mbështetje financiare;
 - d. Një procedurë të bazuar në rregulla, të drejtë dhe transparente të vlerësimit të projekteve që siguron përzgjedhje dhe financim të projekteve të bazuar në merita;
 - e. Proces dhe përgjegjësi të qarta për drejtimin e prokurimit, menaxhimit dhe monitorimit të investimeve në kompetenca komunale.

4. Në afat më të gjatë, kur LMFPP të jetë i hapur për shqyrtim dhe ndryshim, duhet të shtohet një dispozitë e veçantë që mbulon investimet në kompetenca komunale. Kjo dispozitë duhet të kërkojë që të gjitha ministritë të zhvillojnë Udhëzime Administrative që përshkruajnë proceset për kërkimin, përzgjedhjen dhe ekzekutimin e projekteve të IK që bien në përgjegjësinë financiare komunale. Dispozita ligjore gjithashtu duhet të përfshijë kërkesat dhe kriteret e përgjithshme për IK nga ministritë e linjës në kompetencat komunale si kërkesë minimale.

Shtojca I - Investimet Kapitale nga Ministritë sipas Komunave

Investimet Kapitale nga Ministritë tek Komunitet 2011 - 2017

Komuna	2011		2012		2013		2014		2015		2016		2017		TOTALI	
	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%
Komuna Skenderaj	6,941,124	17.01%	4,324,502	12.14%	5,517,782	12.70%	5,249,182	10.28%	9,001,160	20.08%	7,029,372	16.27%	5,289,866	10.09%	43,352,986	13.92%
Komuna Prishtinë	2,355,997	5.77%	1,605,311	4.50%	2,868,850	6.60%	2,168,920	4.25%	205,110	0.46%	6,311,631	14.61%	6,211,517	11.85%	21,727,337	6.98%
Komuna Pejë	1,349,165	3.31%	1,005,410	2.82%	2,770,346	6.38%	6,134,527	12.02%	2,366,501	5.32%	2,374,455	5.50%	4,844,292	9.24%	8,864,695	6.70%
Komuna Gllan	1,802,276	4.42%	2,141,982	6.01%	2,413,106	5.55%	1,638,763	3.21%	1,702,142	3.80%	3,175,133	7.35%	3,068,447	5.85%	15,941,848	5.12%
Komuna Ferizaj	693,230	1.70%	1,299,316	3.65%	1,253,513	2.89%	4,068,919	7.97%	2,415,839	5.39%	3,451,846	7.93%	2,096,451	4.00%	15,279,112	4.91%
Komuna Podujevë	2,595,699	6.36%	2,841,359	7.97%	3,258,220	7.50%	2,421,300	4.74%	1,618,118	3.61%	1,641,736	3.80%	897,674	1.71%	15,274,106	4.91%
Komuna Prizren	3,181,024	7.80%	1,922,150	5.39%	1,300,186	2.99%	1,218,158	2.39%	2,741,754	6.12%	1,639,213	3.79%	2,000,143	3.82%	14,002,628	4.50%
Komuna Suharekë	2,277,948	5.58%	3,151,725	8.84%	2,528,960	5.82%	1,176,866	2.31%	928,467	2.07%	919,574	2.13%	1,054,570	2.01%	12,038,102	3.87%
Komuna Mitrovicë	1,380,111	3.38%	610,014	1.71%	1,380,466	3.18%	1,969,177	3.86%	1,167,818	2.60%	2,127,088	4.92%	2,866,396	5.47%	11,501,069	3.69%
Komuna Istog	1,456,991	3.57%	1,451,706	4.07%	1,984,601	4.57%	2,612,058	5.12%	1,248,525	2.78%	1,561,467	3.61%	1,151,652	2.20%	11,467,000	3.68%
Komuna Shtime	1,480,289	3.63%	1,289,310	3.62%	1,484,942	3.42%	3,598,110	7.05%	1,522,571	3.40%	395,391	0.92%	964,722	1.84%	10,735,335	3.45%
Komuna Decan	1,245,818	3.05%	1,116,156	3.13%	1,497,321	3.45%	2,886,219	5.65%	1,531,637	3.42%	332,971	0.77%	1,139,446	2.17%	9,749,567	3.13%
Komuna Kaçanik	897,648	2.20%	366,812	1.03%	1,244,991	2.87%	2,215,162	4.34%	1,175,666	2.62%	1,101,683	2.55%	2,327,560	4.44%	9,329,543	3.00%
Komunitet e paspecifikuar*	1,075,244	2.64%	1,382,933	3.88%	1,390,939	3.20%	1,683,048	3.30%	993,885	2.22%	615,877	1.43%	1,393,548	2.66%	8,535,474	2.74%
Komuna Klinë	638,633	1.57%	1,424,652	4.00%	2,138,538	4.92%	1,091,536	2.14%	939,876	2.10%	490,065	1.13%	1,256,220	2.40%	7,979,519	2.56%
Komuna Lipjan	777,360	1.91%	689,905	1.94%	1,272,293	2.93%	1,535,290	3.01%	247,034	0.55%	761,935	1.76%	2,063,509	3.94%	7,347,327	2.36%
Komuna Gjakovë	1,298,866	3.18%	1,231,793	3.46%	529,419	1.22%	559,278	1.10%	866,607	1.91%	1,326,995	3.07%	1,224,769	2.34%	7,027,707	2.26%
Komuna Glogoc	987,212	2.42%	465,392	1.31%	706,029	1.63%	1,251,720	2.45%	766,105	1.71%	373,270	0.86%	1,934,959	3.69%	6,484,687	2.08%
Komuna Mitrovica e Veriut		0.00%		0.00%		0.00%		0.00%	5,259,488	11.73%	911,475	2.11%	163,621	0.31%	6,334,594	2.03%
Komuna Rahovec	1,112,438	2.73%	1,072,775	3.01%	1,232,454	2.84%	651,395	1.28%	506,279	1.13%	49,643	0.11%	1,524,804	2.91%	6,149,789	1.93%
Komuna Viti	591,211	1.45%	893,458	2.51%	850,447	1.96%	747,481	1.46%	358,513	0.80%	904,570	2.09%	1,345,994	2.57%	5,691,674	1.83%
Komuna Kamenicë	548,402	1.34%	594,306	1.67%	809,793	1.86%	808,317	1.58%	1,052,739	2.35%	932,050	2.16%	835,812	1.59%	5,581,418	1.79%
Komuna Vushtri	1,373,661	3.37%	834,868	2.34%	953,393	2.19%	314,407	0.62%	9,791	0.02%	543,754	1.26%	1,523,054	2.91%	5,552,927	1.78%
Komuna Dragash	381,054	0.93%	327,728	0.92%	626,576	1.44%	1,136,845	2.23%	277,044	0.62%	505,283	1.17%	651,938	1.24%	3,906,469	1.25%
Komuna Zveçan	214,666	0.53%		0.00%	477,613	1.10%	691,368	1.35%	1,296,840	2.89%	835,653	1.93%	170,102	0.32%	3,686,262	1.18%
Komuna Hani i Elezit	282,668	0.69%	935,662	2.63%	239,539	0.55%	998,853	1.96%	70,000	0.16%	168,462	0.39%	945,927	1.80%	3,641,110	1.17%
Komuna Malishevë	1,246,421	3.05%	733,821	2.06%	579,982	1.33%	249,929	0.49%		0.00%	33,045	0.08%	134,810	0.26%	2,978,007	0.96%
Komuna Zubin Potok		0.00%		0.00%		0.00%		0.00%	2,194,026	4.89%	416,326	0.96%	181,500	0.35%	2,791,852	0.90%
Komuna Fushë Kosovë	819,318	2.01%	540,549	1.52%	533,219	1.23%	258,525	0.51%		0.00%	224,348	0.52%	289,229	0.55%	2,665,189	0.86%
Komuna Obiliq	296,248	0.73%	77,713	0.22%	133,360	0.31%	428,121	0.84%	576,932	1.29%	332,192	0.77%	755,619	1.44%	2,600,185	0.84%
Komuna Leposaviç		0.00%		0.00%		0.00%		0.00%	1,087,333	2.43%	314,064	0.73%	835,590	1.59%	2,236,987	0.72%
Komuna Junik	217,962	0.53%	164,171	0.46%	387,437	0.89%	766,627	1.50%	248,484	0.55%	88,110	0.20%	340,283	0.65%	2,213,073	0.71%
Komuna Graçanicë	538,333	1.32%	143,000	0.40%	19,004	0.04%		0.00%	198,153	0.44%	854,267	1.98%	199,049	0.38%	1,951,866	0.63%
Komuna Novobërdë	19,990	0.05%	209,474	0.59%	333,530	0.77%	74,000	0.14%	40,000	0.09%	157,651	0.36%	299,871	0.57%	1,134,516	0.36%
Komuna Partesh	527,894	1.29%	300,000	0.84%	72,940	0.17%		0.00%	36,429	0.08%	92,576	0.21%	90,279	0.17%	1,120,118	0.36%
Komuna Shtërcë	198,748	0.49%	164,594	0.46%	179,233	0.41%	267,627	0.52%	68,156	0.15%	35,513	0.08%	87,569	0.17%	1,001,440	0.32%
Komuna Ranillug		0.00%	161,019	0.45%	298,336	0.69%		0.00%	18,739	0.04%	102,169	0.24%	97,764	0.19%	678,026	0.22%
Komuna Klokot		0.00%	132,816	0.37%	54,730	0.13%	167,288	0.33%	84,446	0.19%	69,741	0.16%	158,772	0.30%	667,793	0.21%
Komuna Mamusha		0.00%	30,000	0.08%	123,091	0.28%		0.00%		0.00%		0.00%		0.00%	153,091	0.05%
Total	40,803,717	100.00%	35,636,371	100.00%	43,445,179	100.00%	51,039,005	100.00%	44,832,206	100.00%	43,200,604	100.00%	52,417,346	100.00%	311,374,427	100.00%

* Komunitet e paspecifikuar i referohen investimeve të realizuara në kompetenca komunale, për të cilat ka qenë e vështirë të definohet se për cilën komunë ka qenë investimi. Kjo për arsye se përshkrimi i tyre në pasqyra financiare/buxhet është shumë i gjeneralizuar.

Shtojca II - Investimet Kapitale nga Ministritë për Komuna për kokë banori

Investimeve Kapitale për kokë banori									
Komuna	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Shuma totale	Popullësia 2017
Komuna Skenderaj	131.7	82.0	104.7	99.6	170.8	133.4	100.4	822.5	52,711
Komuna Partesh	305.5	173.6	42.2	-	21.1	53.6	52.2	648.2	1,728
Komuna Mitrovica	-	-	-	-	430.9	74.7	13.4	519.0	12,205
Komuna Zveçan	29.1	-	64.7	93.7	175.8	113.3	23.1	499.7	7,377
Komuna Shtime	53.1	46.3	53.3	129.1	54.6	14.2	34.6	385.3	27,864
Komuna Hani i Elezit	28.2	93.5	23.9	99.8	7.0	16.8	94.5	363.8	10,009
Komuna Junik	33.6	25.3	59.8	118.3	38.3	13.6	52.5	341.4	6,482
Komuna Istog	36.2	36.0	49.3	64.9	31.0	38.8	28.6	284.7	40,271
Komuna Kaçanik	26.2	10.7	36.3	64.6	34.3	32.1	67.8	271.9	34,312
Komuna Kllokot	-	48.5	20.0	61.0	30.8	25.4	57.9	243.6	2,741
Komuna Deçan	29.8	26.7	35.8	68.9	36.6	8.0	27.2	232.8	41,876
Komuna Peja	13.5	10.1	27.8	61.5	23.9	23.8	48.6	209.3	99,685
Komuna Klinë	15.9	35.4	53.2	27.1	23.4	12.2	31.2	198.4	40,210
Komuna Gjilan	22.3	26.5	29.9	20.3	21.1	39.3	38.0	197.5	80,727
Komuna Suhareka	37.2	51.5	41.3	19.2	15.2	15.0	17.2	196.8	61,181
Komuna Podujeva	30.8	33.7	38.7	28.7	19.2	19.5	10.7	181.4	84,223
Komuna Kamenicë	17.7	19.2	26.1	26.1	33.9	30.0	26.9	179.9	31,023
Komuna Ranillug	-	42.3	78.4	-	4.9	26.8	25.7	178.1	3,806
Komuna Mitrovica	19.9	8.8	19.9	28.4	16.8	30.7	41.3	165.8	69,365
Komuna Lepsaviç	-	-	-	-	80.0	23.1	61.5	164.5	13,595
Komuna Graçanicë	44.8	11.9	1.6	-	16.5	71.2	16.6	162.6	12,006
Komuna Novobërdë	2.8	29.6	47.1	10.5	5.6	22.3	42.4	160.2	7,080
Komuna Ferizaj	6.8	12.7	12.2	39.7	23.6	33.7	20.4	149.0	102,553
Komuna Shtërpçë	29.3	24.2	26.4	39.4	10.0	5.2	12.9	147.4	6,793
Komuna Obiliq	15.4	4.0	6.9	22.2	30.0	17.2	39.2	135.0	19,262
Komuna Lipjan	13.4	11.9	22.0	26.6	4.3	13.2	35.7	127.1	57,815
Komuna Viti	12.4	18.7	17.8	15.7	7.5	18.9	28.2	119.2	47,758
Komuna Dragash	11.1	9.5	18.2	33.0	8.1	14.7	18.9	113.5	34,411
Komuna Gllgovc	16.1	7.6	11.5	20.4	12.5	6.1	31.6	105.8	61,318
Komuna Prishtina	11.2	7.6	13.6	10.3	1.0	30.0	29.5	103.3	210,282
Komuna Rahovec	18.5	17.9	20.5	10.9	8.4	0.8	25.4	102.5	60,004
Komuna Vushtrri	20.9	12.7	14.5	4.8	0.1	8.3	23.2	84.4	65,761
Komuna Prizren	16.6	10.0	6.8	6.4	14.3	8.6	10.5	73.2	191,268
Komuna Gjakovë	13.5	12.8	5.5	5.8	8.9	13.8	12.7	73.1	96,127
Komuna Fushë Kosovë	21.3	14.0	13.9	6.7	-	5.8	7.5	69.3	38,475
Komuna Malishevë	21.1	12.4	9.8	4.2	-	0.6	2.3	50.4	59,065
Komuna Mamusha	-	5.0	20.7	-	-	-	-	25.7	5,949

Shtojca III - Shpenzimet Kapitale të Ministrisë në Fushat e Kompetencave Komunale

*Shumat në mijra euro	2011		2012		2013		2014		2015		2016		2017		Total	
	€	%	€	%	€	%	€	%	€	%	€	%	€	%	€	%
Ministritë																
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit	13,564	33.24%	11,728	32.91%	19,720	45.39%	30,255	59.28%	23,358	52.10%	21,491	49.75%	28,316	54.02%	148,434	47.67%
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	15,152	37.13%	13,615	38.21%	13,480	31.03%	12,531	24.55%	5,217	11.64%	5,178	11.99%	4,917	9.38%	70,090	22.51%
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	3,386	8.30%	3,824	10.73%	2,659	6.12%	2,907	5.70%	4,449	9.92%	3,297	7.63%	7,675	14.64%	28,198	9.06%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	5,044	12.36%	3,407	9.56%	2,662	6.13%	641	1.26%	2,292	5.11%	2,922	6.76%	2,953	5.63%	19,922	6.40%
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2,251	5.52%	1,418	3.98%	1,492	3.43%	2,164	4.24%	3,105	6.93%	2,510	5.81%	4,645	8.86%	17,586	5.65%
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1,039	2.55%	1,006	2.82%	2,192	5.05%	1,466	2.87%	851	1.90%	5,247	12.15%	194	0.37%	11,996	3.85%
Ministria e Administratës Publike	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	913	2.04%	1,452	3.36%	2,584	4.93%	4,950	1.59%
Ministria e Shëndetësisë	368	0.90%	257	0.72%	634	1.46%	502	0.98%	2,022	4.51%	487	1.13%	429	0.82%	4,698	1.51%
Ministria për Komunitete dhe Kthim	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	2,422	5.40%	199	0.46%	-	0.00%	2,621	0.84%
Ministria për Punë dhe Mirëqenia Sociale	-	0.00%	381	1.07%	427	0.98%	573	1.12%	201	0.45%	245	0.57%	421	0.80%	2,249	0.72%
Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	171	0.40%	282	0.54%	453	0.15%
Ministria e Financave	-	0.00%	-	0.00%	179	0.41%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	179	0.06%
Total	40,804	100.00%	35,636	100.00%	43,445	100.00%	51,039	100.00%	44,832	100.00%	43,201	100.00%	52,417	100.00%	311,374	100.00%

Shtojca IV - Shpenzimet Kapitale të Ministrive të Linjës në Kompetenca Komunale si % e Buxhetit të tyre për Investime Kapitale

Ministrinë	2011			2012			2013			2014		
	Buxheti për IK	IK për komuna	%	Buxheti për IK	IK për komuna	%	Buxheti për IK	IK për komuna	%	Buxheti për IK	IK për komuna	%
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit	275,533,563	13,564,439	4.92	270,150,002	11,728,250	4.34	280,247,511	19,720,055	7.04	189,405,835	30,255,284	15.97
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	27,638,075	15,152,002	54.82	32,266,908	13,614,958	42.19	27,570,184	13,479,571	48.89	26,975,999	12,531,208	46.45
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	5,986,424	3,385,881	56.56	10,405,527	3,824,406	36.75	9,582,683	2,659,016	27.75	8,965,713	2,907,302	32.43
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6,316,909	5,043,578	79.84	4,732,177	3,407,169	72.00	4,356,930	2,662,487	61.11	3,467,000	640,714	18.48
Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	5,396,122	2,250,728	41.71	57,325,425	1,418,148	2.47	46,143,209	1,492,241	3.23	43,864,742	2,163,572	4.93
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	14,750,255	1,039,409	7.05	10,665,130	1,005,718	9.43	10,666,749	2,191,904	20.55	10,169,364	1,466,156	14.42
Ministria e Administratës Publike	10,040,485		-	13,558,436		-	12,276,102		-	12,930,125		-
Ministrinë e Shëndetësisë	7,895,859	367,680	4.66	10,965,198	256,571	2.34	14,121,881	634,470	4.49	14,104,109	501,588	3.56
Ministria për Komunitete dhe Këthim	5,999,515		-	6,000,000		-	6,000,000		-	5,630,000		-
Ministria për Punë dhe Mirëqenia Sociale	2,608,160		-	3,035,000	381,152	12.56	2,390,000	426,930	17.86	2,500,000	573,181	22.93
Ministria për Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural	2,439,205		-	1,695,947		-	1,887,190		-	1,820,000		-
Ministria e Financave	31,937,984		-	4,851,833		-	5,594,487	178,507	3.19	5,622,328		-
TOTAL	396,542,556	40,803,717	10.29	425,651,583	35,636,371	8.37	420,836,926	43,445,179	10.32	325,455,215	51,039,005	15.68
Ministrinë	2015			2016			2017			Total 2011 - 2017		
	Buxheti për IK	IK për komuna	%	Buxheti për IK	IK për komuna	%	Buxheti për IK	IK për komuna	%	Buxheti për IK	IK për komuna	%
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit	188,843,877	23,358,320	12.37	188,843,877	1,491,126	11.38	228,757,600	28,316,329	12.38	1,621,782,265	148,433,802	9.15
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	17,688,404	5,217,390	29.50	17,688,404	5,178,002	29.27	12,061,977	4,916,737	40.76	161,889,951	70,089,867	43.29
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	6,251,717	4,449,170	71.17	6,251,717	3,296,901	52.74	10,472,862	7,675,422	73.29	57,916,643	28,198,098	48.69
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	3,020,864	2,292,159	75.88	3,020,864	2,922,408	96.74	3,327,535	2,953,365	88.76	28,242,279	19,921,879	70.54
Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	35,019,202	3,105,390	8.87	35,019,202	2,510,389	7.17	3,074,806	4,645,058	151.07	225,842,708	17,585,526	7.79
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	10,748,534	851,098	7.92	10,748,534	5,247,475	48.82	11,433,064	194,114	1.70	79,181,630	11,995,873	15.15
Ministria e Administratës Publike	10,946,264	913,352	8.34	10,946,264	1,452,461	13.27	8,555,000	2,584,476	30.21	79,252,676	4,950,288	6.25
Ministrinë e Shëndetësisë	9,444,857	2,022,234	21.41	9,444,857	486,775	5.15	6,165,222	428,896	6.96	72,141,983	4,698,213	6.51
Ministria për Komunitete dhe Këthim	6,592,625	2,422,110	36.74	6,592,625	198,884	3.02	3,160,000		-	39,974,765	2,620,994	6.56
Ministria për Punë dhe Mirëqenia Sociale	1,771,580	200,986	11.34	1,771,580	245,214	13.84	770,715	421,228	54.65	14,847,035	2,248,691	15.15
Ministria për Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural	723,240		-	723,240	170,968	23.64	2,227,943	281,721	12.64	11,516,765	452,689	3.93
Ministria e Financave	502,751		-	502,751		-	4,322,269		-	53,334,403	178,507	0.33
TOTAL	396,542,556	40,803,717	10.29	425,651,583	35,636,371	8.37	420,836,926	43,445,179	10.32	325,455,215	51,039,005	15.68

Shtojca V - Shpenzimet Kapitale të Ministrive të linjës në Kompetenca Komunale si % totale e buxhetit komunal si dhe buxhetit komunal për investime kapitale

Investimet kapitale të ministrive në kompetencat komunale si % totale e buxhetit të komunës			
Komuna	Totali 2011 - 2017		
	Buxheti total	IK nga ministrinë	%
Skenderaj	79,792,041	43,352,986	54.33
Prishtinë	553,864,499	21,727,337	3.92
Pejë	148,720,629	20,864,695	14.03
Gjilan	151,675,335	15,941,848	10.51
Ferizaj	172,348,364	15,279,112	8.87
Podujevë	126,764,665	15,274,106	12.05
Prizren	240,267,750	14,002,628	5.83
Shtime	38,750,822	10,735,335	27.70
Hani i Elezit	14,714,335	3,641,110	24.75
Junik	10,279,450	2,213,073	21.53
Istog	61,085,362	11,467,000	18.77
Kaçanik	45,814,773	2,892,759	6.31
Klllokot	8,066,277	667,793	8.28
TOTAL	1,652,144,302 €	178,059,782 €	10.78

Investimet kapitale të ministrive në kompetencat komunale si % totale e buxhetit të komunës për investime kapitale			
Komuna	Totali 2011 - 2017		
	Buxheti total	IK nga ministrinë	%
Skenderaj	23,674,398	43,352,986	183.1
Prishtinë	287,171,123	21,727,337	7.6
Pejë	42,252,598	20,864,695	49.4
Gjilan	31,635,599	15,941,848	50.4
Ferizaj	62,178,936	15,279,112	24.6
Podujevë	41,725,499	15,274,106	36.6
Prizren	137,597,346	14,002,628	10.2
Shtime	9,892,246	10,735,335	108.5
Hani i Elezit	4,055,379	3,641,110	89.8
Junik	2,414,484	2,213,073	91.7
Istog	16,930,461	11,467,000	67.7
Kaçanik	10,558,543	2,892,759	27.4
Klllokot	2,552,837	667,793	26.2
TOTAL	672,639,449 €	178,059,782 €	26.47

Shtojca VI - Shpenzimet Kapitale në Komuna të ndara sipas burimeve të financimit

Investimet kapitale në komuna të ndara nga burimet e financimit për 2011 - 2017

Komuna	IK nga ministrinë në kompetenca komunale	IK në kompetenca komunal karshi buxhetit të Kosovës		IK në kompetenca komunale karshi IK në grantin e përgjithshëm për komuna	IK si % e IK në grantin e përgjithshëm për komuna	IK në kompetenca komunale karshi grantit të performancës të DEMOS-it		IK në kompetenca komunale karshi fondeve të BE-së	
		Buxheti total i Kosovës	IK si % totale e buxhetit të Kosovës			Shuma total e grantit të performancës nga DEMOS-i	IK në komuna si % e grantit të performancës nga DEMOS-i		Shuma totale e investimve kapitale nga BE-ja
	000€	000€	%	000€	%	000€	%	000€	%
Skënderaj	43,353	10,932,373	0.4%	16,019	37%	-	-	161	-
Pristina	21,727	10,932,373	0.2%	57,232	263%	745	3.43%	270	1.2%
Peja	20,865	10,932,373	0.2%	21,716	104%	729	3.49%	335	1.6%
Gjilan	15,942	10,932,373	0.1%	13,038	82%	-	-	266	1.7%
Ferizaj	15,279	10,932,373	0.1%	32,728	214%	-	-	-	0.0%
Podujevë	15,274	10,932,373	0.1%	31,705	208%	-	-	270	1.8%
Prizren	14,003	10,932,373	0.1%	69,638	497%	-	-	-	-
Suhareka	12,038	10,932,373	0.1%	21,882	182%	-	-	138	1.1%
Mitrovica	11,501	10,932,373	0.1%	15,776	137%	-	-	-	-
Istog	11,467	10,932,373	0.1%	11,146	97%	-	-	-	-
Shitme	10,735	10,932,373	0.1%	7,295	68%	249	2.32%	258	2.4%
Deçan	9,750	10,932,373	0.1%	8,402	86%	-	-	-	-
Kaçanik	9,330	10,932,373	0.1%	5,531	59%	172	1.84%	-	-
Klinë	7,980	10,932,373	0.1%	9,661	121%	-	-	-	-
Lipjan	7,347	10,932,373	0.1%	16,393	223%	303	4.12%	213	2.9%
Gjakovë	7,028	10,932,373	0.1%	21,068	300%	920	13.09%	27	0.4%
Glogovc	6,485	10,932,373	0.1%	16,282	251%	-	-	-	0.0%
Mitrovica e Veriut	6,335	10,932,373	0.1%	8,150	129%	-	-	497	7.8%
Rahovec	6,150	10,932,373	0.1%	17,506	285%	248	4.04%	-	-
Viti	5,692	10,932,373	0.1%	9,216	162%	198	3.48%	-	-
Kamenicë	5,581	10,932,373	0.1%	2,485	45%	80	1.43%	189	3.4%
Vushtrri	5,553	10,932,373	0.1%	18,219	328%	-	-	159	2.9%
Dragash	3,906	10,932,373	0.0%	11,904	305%	-	-	74	1.9%
Zveçan	3,686	10,932,373	0.0%	5,193	141%	-	-	555	15.1%
Hani i Elezit	3,641	10,932,373	0.0%	1,882	52%	139	3.83%	-	-
Malishevë	2,978	10,932,373	0.0%	19,803	665%	-	-	-	-
Zubin Potok	2,792	10,932,373	0.0%	3,719	133%	-	-	-	-

Fushë Kosovë	2,665	10,932,373	0.0%	7,304	274%	-	-	-	-	-
Obiliq	2,600	10,932,373	0.0%	4,402	169%	-	-	-	-	-
Leposaviç	2,237	10,932,373	0.0%	9,506	425%	-	-	1,091	-	48.8%
Junik	2,213	10,932,373	0.0%	1,332	60%	122	5.52%	610	27.6%	11.9%
Graçanicë	1,952	10,932,373	0.0%	11,786	604%	175	8.99%	233	-	-
Novobërdë	1,135	10,932,373	0.0%	2,709	239%	168	14.77%	-	-	-
Partesh	1,120	10,932,373	0.0%	1,004	90%	-	-	-	-	-
Shtërpçë	1,001	10,932,373	0.0%	7,150	714%	-	-	-	-	-
Ranillug	678	10,932,373	0.0%	1,553	229%	81	11.92%	-	-	-
Klokot	668	10,932,373	0.0%	1,681	252%	70	10.45%	-	-	-
Mamusha	153	10,932,373	0.0%	2,173	1419%	-	-	183	119.8%	-
TOTAL	302,839	10,932,373	2.8%	524,185	63.4%	4,399	1.5%	5,528.27	1.8%	-

INVESTIMET KAPITALE NGA
MINISTRITË E LINJËS
NË KOMPETENCA KOMUNALE
PËR PERIUDHËN 2011 - 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



HELVETAS
KOSOVO